

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË E KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE TIRANË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Tiranë me objekt “mbi zbatimin ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” shqyrtimin e kërkesave dhe vendimet e marra nga AKKP për tjetërsimin e oborreve në përdorim, përllogaritjen dhe pagesën e vlerës së truallit dhe dokumentacioni mbështetës, kalimin e fondit të krijuar për llogari të fondit për kompensimin financiar, zbatimin e rregullave dhe respektimin e kritereve për shpërndarjen e fondit të kompensimit pronarëve në të holla, si dhe siguria e nivelit të menaxhimit si dhe transparenca me publikun” për periudhën 01/01/2010-31/12/2011” dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendim të Kryetarit të KLSH nr. 142, datë 30/9/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01/6/2000, me shkresën nr. 653/13, datë 30/9/2012 dërguar z. **Avenir PEKA**, Drejtor i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.** AKKP të aplikojë mekanizma të reja institucionale, duke u bazuar në studimet e kryera nga organizmat vendase dhe të huaja, për ta bërë sjelljen e Agjencisë më fleksibile në raport me përshtatjen në një kohë sa më të shkurtër dhe efektive të ndryshimeve të shpeshta të legjisllacionit, si rezultat i vendimmarrjes politike, për realizimin në një kohë sa më të shkurtër dhe efektive të misionit të AKKP-së.

**Brenda 31.12.2012**

**2.** Të merren masa, nga AKKP Tiranë, që në pjesën arsyetuese të vendimit të përcaktohet legjitimiteti i pasjes dhe të ushtrimit të këtij afati ligjor, me qëllim që aktet e AKKP të mos jenë të kundërshtueshme dhe të atakueshme në gjykatë për shkak të mungesës së kompetencës dhe juridiksionit, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**Vazhdimisht**

**3.** Të merren masa, nga AKKP Tiranë, që formati i vlerësimit ligjor dhe rivlerësimit ligjor të mos ndryshojnë në fund të procesit, por të garantojnë dhe të sigurojnë vazhdimësi procedimore të bazuar në ligj e në detyrat që ngarkon ligji.

**Menjëherë**

**4.** Nga AKKP Tiranë, të hartohet plan veprimi me afate të caktuara për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit në Këshillin e Ministrave (DKBAA), të dërguara me shkresën nr. 2799, datë 24.06.2008.

**Menjëherë**

**5.** AKKP të hartoj një program pune për studimin dhe shpërndarjen e ngarkesës së punës, ristrukturimin me synim shtimin e numrit të ekspertëve gjeodet e topograf, me qëllim që të respektohen afatet ligjore 3-mujore për shqyrtimin e kërkesave dhe aftin 1-mujor për kërkesat ankimore. Kjo në zbatim të kërkesave të nenit 15 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin e kompensimin e pronës” i ndryshuar me nenin 17/2 të ligjit nr. 9583, datë 17.7.2006, me nenin 15 ligjit nr. 10207, datë 23.12.2009, me nenin 18 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” i ndryshuar, me VKM nr. 200, datë 19.02.2009 “Për përcaktimin e kushteve dhe për procedurën e tjetërsimit të oborreve në përdorim, për llogari të fondit të kompensimit financiar”, pika IV/1 “Procedura e shqyrtimit të kërkesës”.

**Brenda 31.12.2012**

6. Nga AKKP të ngrihet grup pune, i cili të hartojë dhe të paraqesë për miratim Rregulloren e Brendshme, pasi rregullorja aktuale i përket vitit 2008 dhe nuk përmbush kërkesat sipas ndryshimeve të legjislationit në fuqi.

**Menjëherë**

7. AKKP të marrë masa urgjente për sistemimin e dosjeve në arshivë, pasi gjendja e tyre është jashtë kushteve të ruajtjes, sigurisë dhe cilësisë të kërkuar, të bëjë inventarizimin dhe plotësimin e dokumentacionit sipas regjistrave, për të mos penguar subjektet nga e drejta e kompensimit.

**Menjëherë**

8. Nga AKKP të merren masa për të përcaktuar qartë mënyrën e funksionimit të strukturave të saj vartëse (Drejtorinë e Kthimit dhe Drejtorinë Juridike dhe Kontrollit) me qëllim përfshirjen e tyre në shprehjen e mendimit ne akte te posaçme, për ecurinë e dosjeve të ish pronarëve të shpronësuar, si nevojë e nxjerrjes së vendimit përfundimtar te bazuar.

**Menjëherë**

9. Të merren masa që, për dosjet që AKKP është shprehur më parë me vendim përfundimtar, të përvijohet deri ne administrimin e tyre pa rene ndesh me ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin e kompensimin e pronës” i ndryshuar.

**Vazhdimisht**

10. Nga AKKP të merren masa të organizohet puna me strukturat e saj për respektimin e afatit ligjor 30 ditë, të pagesës së tjetërsimit me kundërshtëpërbllim, në zbatim të kërkesave të VKM nr. 200, datë 19.02.2009 kreu IV/6/a dhe IV/7.

**Vazhdimisht**

11. Nga AKKP të vlerësohet drejt dhe të respektohet kriteri interes publik për tjetërsimin e oborreve në përdorim pa kundërshtëpërbllim në përputhje me ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin e kompensimin e pronës” i ndryshuar, me VKM nr. 255, datë 13.04.2010 “Për procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të akteve të subjekteve të shpronësuar, gjatë procesit të njohjes dhe kthimit apo kompensimit të pronës”, pika III/b si dhe me Vendimin nr. 30, datë 01.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese.

**Vazhdimisht**

**B. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 141 dhe neni 153 pika 1, 2 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe kontratës individuale të punës, t’i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së, që të fillojë procedura për dhënien e masës disiplinore:

**I. “Zgjidhjen e kontratës së punës”**

1. ■ me detyrë, Përgjegjës i Sektorit të Shqyrtimit për Qarkun Tiranë, Elbasan, Dibër, për:  
- keqmenaxhim dhe keqadministrim te procesit te njohjes dhe kthimit te pronave, gjatë fazës se mbikëqyrjes se elementeve dhe etapave te procedimit hetimor administrativ, deri ne daljen e aktit; për të meta e mangësi, mbi zbatimin e afatit ligjor për trajtimin e ankesave të paraqitura nga subjektet e shpronësuar për shkeljet e konstatuar në zbatim të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” të ndryshuar, nenin 15, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, germa “a” neni 18 dhe të Rregullores “Për organizimin e punës në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” neni 12, 19, 23 dhe 25.

- konstatimet dhe problematikat lidhur me 13 dosjet ankimore të Avokatit të Shtetit, të cilat nuk janë shqyrtuar brenda afatit 3-mujor, veprim në kundërshtim me nenin 15/1a/ii, të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” të ndryshuar, por janë zgjatur nga 1 deri në 3 vjet, veprime këto që, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 43, datë 6.10.2011, kanë bërë që këto vendime të ankimuara të dalin jashtë juridiksionit dhe kompetencës së AKKP-së për shqyrtim.

2. ■ me detyrë, Përgjegjës i Sektorit të Tjetërsimit të Sipërfaqeve Shtetërore, për:

- vonesa në trajtimin e dosjeve, duke tejkaluar afatin maksimal prej 3 muaj, në kundërshtim me VKM nr. 200, datë 19.02.2009, i ndryshuar, “Për përcaktimin e kushteve dhe për procedurën e tjetërsimit të oborreve në përdorim, për llogari të fondit të kompensimit financiar”, Kapitulli IV, pika 1.

- tjetërsime të sipërfaqeve, në një kohë që Bashkia Tiranë, i ka bërë me dije AKKP-së se pronat janë pjesë të sipas studimeve ose planeve urbanistike të ndryshme dhe si të tilla nuk duhej të procedohej me kthimin e pronës dhe trualli të përdorej për interes publik, veprime në kundërshtim me nenin 7/1, të Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës”.

-tjetërsime të oborreve në përdorim në një kohë që sipërfaqja ka patur ndërtime informale, veprime në kundërshtim me VKM nr. 200, datë 19.02.2009, të ndryshuar, Ndarja I, pika 2.

-tjetërsime të oborreve në përdorim në një kohë që nuk provohet fakti se ndërtimi i cili gjendet brenda ose në lidhje funksionale me oborrin në përdorim që kërkohet të tjetërsohet, është kryer përpara datës 10.08.1991, në kundërshtim me VKM nr. 200, datë 19.02.2009, i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, a/ii dhe Kap. III, pika 3/ç.

-tjetërsime të oborreve në përdorim mbi bazën e regjistrimit të ndërtesave sipas vendimeve të gjykatës, vërtetim fakti juridik të ndërtimit të banesës, veprim ky në kundërshtim me nenin 17/3, të Ligjit nr. 9235, datë 29.07.1994, “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës”.

3. ■ me detyrë, Përgjegjës i Sektorit të Shqyrtimit për Qarkun Vlorë, Fier, Gjirokastrë, për:

- keqmenaxhim dhe keqadministrim te procesit te njohjes dhe kthimit te pronave, gjate fazës se mbikëqyrjes se elementeve dhe etapave te procedimit hetimor administrativ, deri ne daljen e aktit; për të meta e mangësi, mbi zbatimin e afatit ligjor për trajtimin e ankesave të paraqitura nga subjektet e shpronësuara për shkeljet e konstatuar në zbatim të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” të ndryshuar, nenin 15, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, germa “a” neni 18 dhe të Rregullores “Për organizimin e punës në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” neni 12, 19, 23 dhe 25, për konstatimet dhe problematikat lidhur me 13 dosjet ankimore të Avokatit të Shtetit, të cilat nuk janë shqyrtuar brenda afatit 3-mujor, veprim në kundërshtim me nenin 15/1a/ii, të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” të ndryshuar, por janë zgjidhur nga 1 deri në 3 vjet, veprime këto që, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 43, datë 6.10.2011, kanë bërë që këto vendime të ankimuar të dalin jashtë juridiksionit dhe kompetencës së AKKP-së për shqyrtim.

4. ■ me detyrë ing. Gjeodet, për:

-Për të meta e mangësi, mbi zbatimin e afatit ligjor për trajtimin e ankesave të paraqitura nga subjektet e shpronësuara për shkeljet e konstatuar në zbatim të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” të ndryshuar, nenin 15, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, germa “a” neni 18 dhe të Rregullores “Për organizimin e punës në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” neni 12, 19, 23 dhe 25.

**II. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, në bazë të nenit 6, pika 6.5 të Kontratës së Punës me afat të pa caktuar, në ushtrimin e kompetencave të tij të vendos për dhënie masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”, “Pezullim nga drejta e ngritjes në detyrë për një periudhë deri në dy vjet”, “Kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët për një periudhë 30 ditë deri në 1 vit” deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”, për:**

1. ■ me detyrë, Jurist;

2. ■ me detyrë, Juriste;

3. ■ me detyrë, Juriste, për:

-të meta e mangësi, në zbatimin e afateve ligjore në trajtimin e ankesave të paraqitura nga subjektet e shpronësuara për shkeljet te aspektit teknik e procedural te konstatuar ne aktet pjese përbërëse e dosjes, e qe bien ne kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” të ndryshuar, nenin 15, të ligjit nr.

8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, germa “a” neni 18 dhe të Rregullores “Për Organizimin e Punës në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” neni 12, 19, 23 dhe 25.

4. ■ me detyrë, Jurist;

5. ■ me detyrë, Juriste;

6. ■ me detyrë, Jurist;

- të meta e mangësi në lidhje me 13 dosjet ankimore të Avokatit të Shtetit, të cilat nuk janë shqyrtuar brenda afatit 3-mujor. Veprime këto, në kundërshtim me nenin 15/1a/ii, të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” të ndryshuar, të cilët janë zgjatur nga 1-3 vjet, veprime këto që, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 43, datë 6.10.2011, kanë sjellë pasojë që këto vendime të ankimuar të dalin jashtë juridiksionit dhe kompetencës së AKKP-së për shqyrtim si edhe për shkeljet te aspektit teknik e procedural te konstatuar ne aktet pjese përbërëse e dosjes, e qe bien ne kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004.

7. ■ me detyrë, Juriste;

8. ■ me detyrë, Juriste;

9. ■ me detyrë, Jurist, për:

- vonesa në trajtimin e dosjeve, duke tejkaluar afatin maksimal prej 3 muaj, në kundërshtim me VKM nr. 200, datë 19.02.2009, i ndryshuar, “Për përcaktimin e kushteve dhe për procedurën e tjetërsimit të oborreve në përdorim, për llogari të fondit të kompensimit financiar”, Kapitulli IV, pika 1.

- tjetërsime të sipërfaqeve, në një kohë që Bashkia Tiranë, i ka bërë me dije AKKP-së, se pronat janë pjesë të studimeve ose planeve urbanistike të ndryshme dhe si të tilla nuk duhej të procedohej me kthimin e pronës dhe trualli të përdorej për interes publik, veprime këto në kundërshtim me nenin 7/1, të Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës”.

- tjetërsime të oborreve në përdorim në një kohë që sipërfaqja ka patur ndërtime informale, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 200, datë 19.02.2009, të ndryshuar, Ndarja I, pika 2.

- tjetërsime të oborreve në përdorim në një kohë që nuk provohet fakti se ndërtimi i cili gjendet brenda ose në lidhje funksionale me oborrin në përdorim që kërkohet të tjetërsohet, është kryer përpara datës 10.08.1991, në kundërshtim me VKM nr. 200, datë 19.02.2009, i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, a/ii dhe Kap. III, pika 3/ç.

- tjetërsime të oborreve në përdorim mbi bazën e regjistrimit të ndërtesave sipas vendimeve të gjykatës, vërtetim fakti juridik të ndërtimit të banesës, veprim ky në kundërshtim me nenin 17/3, të Ligjit nr. 9235, datë 29.07.1994, “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës”.

10. ■ me detyrë, Jurist;

11. ■ me detyrë, Jurist;

12. ■ me detyrë, ing. Gjeodet;

13. ■ me detyrë, Juriste;

14. ■ me detyrë, ing. Gjeodet;

15. ■ me detyrë, Jurist;

16. ■ me detyrë, Topografe, për;

- të meta e mangësi në lidhje me 13 dosjet ankimore të Avokatit të Shtetit, të cilat nuk janë shqyrtuar brenda afatit 3-mujor, veprim në kundërshtim me nenin 15/1a/ii, të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” të ndryshuar, por janë zgjatur nga 1 deri në 3 vjet, veprime këto që, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 43, datë 6.10.2011, kanë bërë që këto vendime të ankimuar të dalin jashtë juridiksionit dhe kompetencës së AKKP-së për shqyrtim.

- të meta e mangësi, mbi zbatimin e afatit ligjor për trajtimin e ankesave të paraqitura nga subjektet e shpronësuara për shkeljet e konstatuar në zbatim të ligjit nr. 9235, datë

29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” të ndryshuar, nenin 15, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, germa “a” neni 18 dhe të Rregullores “Për organizimin e punës në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” neni 12, 19, 23 dhe 25.

17. ■ me detyrë, Juriste;

18. ■ me detyrë, ish Përgjegjëse e Sektorit të Vlerësimit dhe Shpërndarjes së Kompensimit;

19. ■ me detyrë, Juriste, për:

-të meta e mangësi në zbatim të VKM nr. 192, datë 9.3.2011 “Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit, pronarëve në të holla, për vitin 2011” dalë në mbështetje të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP nr. 329, datë 29.7.2011 sipas të cilit AKKP ka detyrimin ligjor të përmbush një të drejtë tërësisht legjitime në favor të subjektit të shpronësuar pavarësisht problematikave të tilla të konstatuara.

**III.** Për të meta dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, për ish-punonjësit ■, ■, ■, ■, ■, ■, ■, ■, të cilët nuk janë në marrëdhënie pune me institucionin rekomandojmë: AKKP-ja për ish-punonjësit e sipërcituar të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, të cilët në ushtrimin e detyrës administrative në AKKP, kanë ndikuar negativisht në funksionimin administrativ të AKKP-së.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Albert Thoma, Besim Bileri, Aleksandër Papadhimitri, Evis Kreshpaj dhe Qemal Shehu. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Bajram Lamaj, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj dhe Drejtori Juridik dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

## **KONTROLI I LARTË I SHTETIT**